



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA

MINISTRIA E ARSIMIT, E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY

Kabineti i ministrit

Kabinet ministra

Cabinet of the minister

UDHËZIM ADMINISTRATIV

Raporti nxënës-mësimdhënës dhe raporti nxënës-personel jo-mësimdhënës si dhe numri i nxënësve për paralele i përkufizuar për qëllime të përcaktimit të (i) grantit shtetëror të arsimit për komuna dhe (ii) alokimeve të personelit të bëra nga komuna për shkolla

NUMËR: 18/2009

DATA: 28.08.009

Në mbështetje të neneve 93 (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 25 paragrafit 7 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Kosovës nr. 1/2007, Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe Teknologjisë nxjerr këtë : Udhëzim administrativ

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij Udhëzimi administrativ është:

1. Përcaktimi i formulës së përdorur nga Komisioni i Granteve për të përcaktuar grantin e arsimit për komuna që të përkufizohet raporti nxënës-mësimdhënës dhe nxënës-personel jo-mësimdhënës
2. Alokimi i personelit në shkolla nga komuna
 - Për të përcaktuar numrin maksimal dhe minimal të nxënësve për paralele në shkollat e komunës;
 - 2.2. Përkufizon të drejtën e shkollave ndaj pozitave të personelit profesional dhe administrativ;
 - 2.3. I jep fleksibilitet komunave për të përcaktuar mënyrën e sigurimit të shërbimeve të pastrimit dhe të sigurimit për shkolla.

Neni 2

Raportet nxënës-mësimdhënës të përkufizuara në formulën shtetërore për përcakimin e grantit për arsim në komuna

Faza e arsimit dhe lloji i shkollës	Nxënësit për mësimdhënës ose edukator	
	Nxënësit e komunitetit shumicë	Nxënësit e komunitetit pakicë
Arsimi parashkollor duke përfshirë fëmijët 5-6 vjeçar në paralele të shkollave fillore	12	12
Nxënësit e shkollës fillore (klasët 1-9)	21.3	14.2
Nxënësit e gjimnazit (klasët 10-13)	21.3	14.2
Nxënësit e shkollës profesionale (klasët 10-13)	17.2	11.5
Nxënësit në shkolla të zonave malore (700 metra ose më tepër të lartësisë mbidetare)	14.3	14.2

1. Nxënësit e komunitetit pakicë janë nxënës që mësojnë në paralele të ndara në një gjuhë që dallon nga gjuha e punës së nxënësve të komunitetit shumicë që vijojnë shkollën. Prandaj, nxënësit pakicë mund ti takojnë çdo grupi etnik, varësisht nga përbërja etnike e nxënësve të shkollës. Në këtë mënyrë numri i nxënësve pakicë identifikohet në nivel të shkollës. Totali në çdo komunë nxirret duke e mbledhur numrin e nxënësve pakicë nga secila shkollë e komunës.
2. Këto raporte nxënës-mësimdhënës përkufizohen të jenë në përputhje me ato që kërkohen në Udhëzimin administrativ 6/2008 për arsimin parashkollor dhe Udhëzimin administrativ 26/2008 për planprogramin mbi arsimin profesional.

3. Udhëzimi administrativ 6/2008, u referohet fëmijëve prej 0 deri 6 vjet. Për qëllime të formulës shtetërore raporti nxënës-mësimdhënës për fëmijët dhe nxënësit e moshës 5-6 vjeçare në shkolla fillore është 12.

Neni 3

Raportet nxënës-personel administrativ/profesional të përkufizuar në formulën shtetërore për përcaktimin e grantit për arsim në komuna

1. Drejtori i shkollës për shkollën amë:
 - 1.1. Një (1) person administrativ/profesional (pa kategori specifike) për 630 nxënës parafillor (moshat 2-6 vjet) dhe nxënësit e shkollës fillore (klasët 1 deri 9).
 - 1.2. Një (1) person administrativ/profesional (pa kategori specifike) për 470 nxënës të shkollës së mesme (klasët 10 deri 13).

Neni 4

Raportet nxënës-personel ndihmës të përkufizuar në formulën shtetërore për përcaktimin e grantit për arsim në komuna

1. Një (1) roje sigurimi për shkollë
2. Një (1) pastrues për 170 nxënës

Neni 5

Vendimet e komunës lidhur me raportet nxënës-mësimdhënës dhe nxënës-personel jo-mësimdhënës

1. Raportet nxënës-personel të përkufizuar në nenet 2,3 dhe 4 janë në përdorim vetëm për formulën shtetërore për përcaktimin e grantit për arsim në komuna. Nga komunat nuk kërkohet që ti zbatojnë në përpikshmëri këto raporte kur të vendosin se si ta alokojnë buxhetin ose personelin në shkolla, me përjashtim ku specifikohet më poshtë.

Neni 6

Numri i fëmijëve në arsimin parafillor për paralele/grup dhe raportet e personelit

1. Udhëzimi administrativ 6/2008 u referohet edhe raporteve nxënës-edukator për fëmijët e moshës parashkollore. Këto raporte janë paraqitur më poshtë. Ato i referohen fëmijëve në këto grup-mosha si në shkollën parafillore ashtu edhe në atë fillore.

Grup- mosha	Numri optimal i fëmijëve për paralele ose grup	Numri maksimal i fëmijëve për paralele ose grup
-------------	------------------------------------------------	-------------------------------------------------

Nën 1	8	10
1-2 vjet	12	14
2-3 vjet	14	16
3-4 vjet	20	22
4-5 vjet	22	24
5-6 vjet	24	26

2. Në të gjitha grup- moshat nevojiten 2 edukatorë për paralele/grup.

Neni 7

Numri i nxënësve për paralele në shkollat fillore dhe të mesme

Faza/lloji i shkollës	Normal (shumicë)	Maksimum (të gjithë)	Minimum: shumicë	Minimum: pakicë	Minimum: zonat malore
parafillore mosha 5-6	24 me 2 edukatorë për paralele	26	10	10	5
fillore klasët 1-9	30	35	10	5	5
gjimnazi klasët 10-13	32	35	20	10	10
shkolla profesionale: paralelet teorike	32	35	20	10	10
shkolla profesionale: paralelet praktike	16	19	10	10	10

- MASHT-i mund ta aprovojë kërkesën e drejtorëve komunal të arsimit që disa paralele të kenë më shumë nxënës se maksimumi i specifikuar më lartë: kërkesa duhet ti cek paralelet dhe shkollat të cilat i referohen kërkesës dhe arsyet për nevojën e një numri më të madh të nxënësve se sa maksimumi.
- Aty ku numri i nxënësve në një shkollë është nën 10, mund të organizohen paralelet me klasë të përzier prej 2 ose më së shumti 3 klasëve.

Neni 8

Personeli administrativ dhe profesional

1. Çdo shkollë amë duhet ta ketë drejtorin e shkollës. Në qoftë se shkolla ka më pak se 250 nxënës, drejtori i shkollës do ta mbajë gjysmën e normës së orëve të një mësimdhënësi të rregullt me normë të plotë.
2. Shkolla me 1000 nxënës ose më shumë në vijim mund ta ketë zëvendësdrejtorin.
3. Shkollës me 1500 nxënës ose më shumë i alokohet një pozitë e bibliotekistit.
4. Shkollës me 1500 nxënës ose më shumë i alokohet një pedagog (psikolog i arsimit).
5. Shkollës me 500 nxënës ose më shumë i alokohet një pozitë e administratorit. Në shkollat të cilat e menaxhojnë buxhetin e tyre, administratori duhet të merret me shënime financiare dhe raportim (kontabilitet).
6. Shkollat të cilave u është alokuar buxheti i vet për ta menaxhuar, duke përfshirë edhe personelin, nuk janë të lidhura me rregullat e mësipërme. Këshilli i Shkollës mund të vendos ta krijojë një pozitë të personelit administrativ ose profesional dhe ta paguajë atë me rrogë nga buxheti i shkollës, me kusht që të ketë fonde të mjaftueshme në buxhetin e shkollës. Kjo pozitë e re mund të krijohet vetëm në qoftë se kjo pozitë është e përfshirë në planin e buxhetit shkollor që miratohet nga drejtori i arsimit komunal.

Neni 9

Personeli ndihmës

1. Komuna e ka për detyrë të sigurojë që të gjitha shkollat të mbahen në një nivel të lartë të pastërtisë dhe që prona e shkollës dhe personat të jenë të sigurt.
2. Komunat janë fleksibile në përcaktimin e mënyrës se si kryhen këto detyra.
3. Nuk është përkufizuar ndonjë raport specifik i sipërfaqes shkollore me numrin e pastruesve/rojeve ose raportit nxënës-pastrues.
4. Komunat mund të angazhojnë organizata të sektorit privat për shërbimet e pastrimit dhe sigurisë. Në qoftë se e bëjnë këtë, komunat duhet t'u përmbahen rregullave të zakonshme të prokurimit.

Neni 10


Dispozitat shfuqizuese

1. Me hyrjen në fuqi të këtij U.A. shfuqizohen U.A. nr. 16/2002 dhe 04/2003 si dhe të gjitha dispozitat nënligjore qe bien në kundërshtim me këtë U.A.

Neni 11.

Hyrja në fuqi

1. Ky U.A hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga ministri.



Enver Hoxhaj, ministër